

NË EMËR TË POPULLIT

P. nr.905/2018

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Selvije Kostërci, në lëndën penale ndaj të pandehurit A.H. nga ..., për shkak të veprës penale: Rrezikimi i trafikut publik neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2845/2018 të datës 26.10.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt. 15.02.2019 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Slobodan Bakic dhe të pandehurit, të njëjtën ditë e shpalli publikisht, ndërsa me datë 19.02.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.H., nga i ati ... dhe e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me datë ... në ..., me vendbanim në fshatin ..., komuna e ..., i pa martuar, me profesion automekanik, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Me datë 31.01.2017, rreth orës 22:40, në Mitrovicë, në rrugën "...", në ..., nga drejtimi i ... në drejtim të fshatit ..., me të arritur në afërsi të shtëpisë së A. M., derisa ishte duke e drejtuar automjetin "VW Golf 19 E", ngjyrë e zezë, me targa ..., nga pakujdesia e në kundërshtim me dispozitën e nenit 41 e 53 të Ligjit për rregullat në trafikun rrugor, mos ngasjes së obliguar në anën e djathtë por ka lëvizur majtas si dhe shpejtësinë e lëvizjes nuk ia ka përshtatur kushteve dhe gjendjes së rrugës, dhe me të parë pengesën në rrugë në pamundësi të ndaljes së automjetit duke mos treguar kujdes të veçantë ndaj pjesëmarrësve në komunikacionin rrugor, përkatësisht ndaj këmbësorëve, me pjesën e përparme të anës së majtë të automjetit (me pjesën ballore, xhamin e parë majtas) e godet këmbësorin – të dëmtuarin M.I., i cili në ato momente ishte duke ecur në drejtimin e njëjtë, në cepin e rrugës në anën e majtë të drejtimin të lëvizjes së automjetit, ku pas goditjes këmbësorin e hudhë në parafangon e automjetit në pjesën e majtë dhe e përplas në trotuar në anën e majtë të rrugës, me ç'rast të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore dhe atë: kontuzion në regjionin gluteal (vitheve) të majtë, me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Me këtë ka kryer veprën penale: Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 73, të KPRK-së, dhe nenit 450, 460 të KPP-së, e:

G J Y K O N

I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 350 € (treqind e pesëdhjetë euro) të cilën shumë obligohet ta paguaj brenda afatit prej tre (3) muajve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në rast se i pandehuri nuk e paguan gjobën, atëherë kjo shumë e dënimit me gjobë i shndërrohet menjëherë në dënim me burgim sipas ligjit.

II. OBLIGOHET i pandehuri, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimare të gjykatës, dhe atë për ekspertizën e komunikacionit shumë prej 51.10€, për ekspertizën mjeko-ligjore shumë prej 20€, në

emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. I dëmtuari, M.I., me adresë: Rr. “...” në ..., për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridik civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.2845/2018 të datës 26.10.2018, kundër të pandehurit A.H. nga ..., për shkak te veprës penale: Rrezikimi i trafikut publik neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ashtu që në këtë seancë i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës, duke theksuar se e ndjej veten fajtor për veprën penale që i vihet në barrë si dhe ka shprehur keqardhje për atë që ka ndodhur, kjo është hera eparë që ka ra ndesh me ligjin dhe i premtoj gjykatës që në ardhmen do të jem më i kujdesshëm në trafikun publik.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se i pandehuri e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare, ky pranim është në pajtim edhe me provat materiale, gjendjen faktike dhe kualifikimin ligjor të veprës penale, andaj i propozon gjykatës që ta pranojë pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe me rastin e shqiptimit të dënimit t'i merr parasysht të gjitha rrethanat si dhe faktin se për herë të parë ka ra ndesh me ligjin.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Kallëzimi penal i policisë me nr. 2017-BR-064 i dt. 31.01.2017; Raporti i oficerit i dt. 31.01.2017; Deklarata e të pandehurit dhënë në polici e dt. 01.02.2017; Deklarata e të dëmtuarit M.I. dhënë në polici 04.02.2017; Mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr.N.H., i datës 27.09.2018; Mendimi dhe Konstatimi i ekspertit të komunikacionit rrugor, Ing. S.B., i datës 01.10.2018; Fotodokumentacionin nga vendi i ngjarjes. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri, ka kryer veprën penale që i vihen në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale: Rrezikimi i trafikut publik neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK, e për të cilën vepër penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit ne mbështetje të nenit 73 të KPK-ës. Si rrethana rënduese ka gjetur mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e që kjo vepër penale ka qellim të mbrojë jetën dhe trupin e individit, rrethanat më të cilat është kryer vepra po ashtu gjykata e ka vlerësuar si rrethanë rënduese. Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shprehe keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, duke premtuar se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshë, sjellja korrekte e të pandehurit në gjykatë dhe faktin se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me gjobë, ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Poashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 par 1 të KPRK-së, që ti parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Poashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga veprimet e ndaluara në komunikacion.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.1 dhe 2.6 dhe nenit 453 par.1 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet për ekspertë dhe të paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimn viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.905/2018, dt.19.02.2019

Procesmbajtësja:
Selvije Kostërci

Gjyqtari

Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjyaktës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.